

Ekskluzive

Ekskluzive | Antidroga ndalon “Opel Merivën” në Dragash – 25-vjeçarit i gjendet pistoletë TT me 8 fishekë në brez, përfundon në ndalim



Sinjali.com

03 Gusht 2026 10:42



Një aksion i përbashkët i Policisë dhe Njesisë së Antidrogës në kuadër të planit operativ “Vera 2026” ka çuar në arrestimin e një 25-vjeçari, pasi gjatë kontrollit iu gjet një armë zjarri e mbajtur pa autorizim.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Eliot Krasniqi**, 25 vjeçar.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 2 gushtit, rreth orës 23:30, në kthesën e Rapqes, në rrugën Prizren–Dragash, ku patrulla policore dhe Njësia e Antidrogës kishin ngritur pikë kontrolli në kuadër të planit operativ “Vera 2026”.

Gjatë kontrollit të një veture Opel Meriva me ngjyrë kaltër metalike, zyrtarët policorë kanë kontrolluar pasagjerin, Eliot Krasniqin, të cilit në brez i është gjetur një pistoletë e tipit TT, së bashku me një karikator të mbushur me tetë fishekë.

Pas sekuestrimit të armës, i dyshuari është arrestuar, ndërsa automjeti dhe personat e tjerë që ndodheshin në të janë shoqëruar në Stacionin Policor në Dragash, ku është kryer edhe një kontroll shtesë i veturës.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, pasagjerët e tjerë janë intervistuar dhe më pas janë liruar, ndërsa ndaj Eliot Krasniqit është iniciuar procedurë për veprën penale “Armëmbajtje pa leje”.

Me vendim të Prokurorit, 25-vjeçari është ndaluar për 48 orë, ndërsa arma me municion është sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera